



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 481/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-20671-05-06-2019, me objekt: “*Boje sinjalistike horizontale*”, me fond limit 2.082.750 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.05.2019 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë.”

Ankimues: Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k.
Rr.Kastriotet, Ndërtesë me zonë Kadastrale 2679, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë.
Rr. “28 Nëntori” Nr.1,Lgj.7, Kodi Postar 7001, Korçë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-20671-05-06-2019, me objekt: “*Boje sinjalistike horizontale*”, me fond limit 2.082.750 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 20.05.2019 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 20.05.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1.	“Elda-VI” sh.p.k	0. 00, skualifikuar
2.	“Sark” sh.p.k	1.648.500,00 lekë, skualifikuar
3.	“Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k	1.697.250,00 lekë, skualifikuar
4.	“Deutschcolor” sh.p.k	1.824.000,00 lekë, skualifikuar
5.	“Bolt” sh.p.k.	2.010.750,00 lekë, skualifikuar
6.	“IDK - Konstruktion” sh.p.k	2.041.800,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k është skualifikuar pasi:

“Operatori juaj nuk ka paraqitur dokumenta qe vertetojne plotesimin e kriterëve te veçanta te kualifikimit te dokumenteve standarte te tenderit, kapaciteti teknik pika 3 e tij ku kerkohen:

“1. Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara”.

Kontrata me nr. 4834/3 te dates 27.07.2015 te lidhur me AK Komanden Mbeshtetese, reparti ushtarak nr. 4001 objekt i se ciles eshte furnizimi me materiale per mirembajtje kazermash nuk eshte realizuar gjate 3 viteve te fundit si kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Kontrata me nr. 4049/7 e dates 03.08.2016 e lidhur me AK Komanda e Forses Tokesore , Reparti ushtarak 1001, Zall-Herr Tirane, objekt i se ciles eshte blerje materiale kazermimi per mbeshtetjen e stervitjes joint Effort Biza 2016” nuk permban furnizime te ngjashme ne vleren 833,100 leke pa TVSH apo 40% te fondit limit te kerkuar ne kriteret e veçanta te kualifikimit, kapaciteti teknik.”

II.3. Në datën 31.05.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në të cilën kundërshton skualifikimin e ofertës së tij. Konkretisht pretendohet si vijon:
“ [...]

Duke u nisur nga dokumentat e hedhura në sistem, kompania jonë ka hedhur kontratën me nr. 4049/7, e datës 03.08.2016, e lidhur me repartin ushtarak 1001, Zall Herr Tiranë, me objekt: “Materiale kazermimi”, vlere e së cilës është më e madhe se fondi limit për këtë procedurë prokurimi (kontrata bashkëngjitur).

Pra duke qënë se kërkohet si në DST ashtu edhe në rregullat e prokurimit publik për kontratat e mallrave “Furnizime te ngjashme” dhe jo furnizime të së njëjtës natyrë, e cila do të conte në shkeljen e LPP-së, pretendojmë që kjo kërkesë është përmbushur nga ana jonë. Gjithashtu ne kemi furnizuar dhe klientë apo autoritete private vetëm me objektin “bojë”, por nuk janë parë të arsyeshme për t’u ngarkuar në sistem, pasi kontrata e mësipërme e justifikonte kualifikimin e kësaj pike (fatura bashkëngjitur, jo të hedhura në sistem).”

II.4. Me shkresën nr. 436/1 prot., datë 31.05.2019, me objekt: “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën, si më poshtë vijon:

“[...]

Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k rezulton se është paraqitur dokumentacioni si vijon:

- 1. Vërtetimi nr.1087/2 prot., i datës 28.02.2017 për realizimin e kontratës me objekt: “Blerje materiale kazermimi për mbështetjen e stërvitjes Join Effort Biza 2016 në vlerën 2.784.272 lekë me tvsh.*
- 2. Kontrata 4049/7, datë 31.08.2016 me Komandën e Forcës Tokësore Zall Herr, Tiranë.*

3. Faturë tatimore nr.615, datë 05.09.2016
4. Faturë tatimore nr.616, datë 05.09.2016
5. Faturë tatimore nr.617, datë 05.09.2016
6. Faturë tatimore nr.618, datë 05.09.2016
7. Faturë tatimore nr.619, datë 05.09.2016
8. Faturë tatimore nr.620, datë 05.09.2016
9. Faturë tatimore nr.621, datë 05.09.2016
10. Faturë tatimore nr.622, datë 05.09.2016
11. Faturë tatimore nr.623, datë 05.09.2016
12. Faturë tatimore nr.624, datë 05.09.2016

[...] Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar si dëshmi të eksperiencës së mëparshme të ngjashme me objektin e kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatohet se nga ana e operatorit ekonomik ankimues janë dorëzuar dëshmi të furnizimeve të mëparshme lidhur me person juridik publik, konkretisht kontrata e lidhur me Komandën e Forcës Tokësore Zall Herr Tiranë me objekt: “Blerje materiale kazermimi për mbështetjen e stërvitjes Joint Effort Biza 2016”.

Në nenin 2 të kësaj kontrate si dhe faturat bashkëlidhur janë listuar materialet që do të shërbejnë për mirëmbajtje kazermash vlera totale e të cilave është 2.320.227 lekë pa tvsh dhe 2.784.272 lekë me tvsh. Në interpretim të nenit 27, pika 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për të provuar eksperiencën e mëparshme duhet të plotësohen krahas kushtit të vlerës në tërësi të dëshmisë/ve të furnizimit edhe kërkesa mbi ngjashmërinë e furnizimeve të realizuara, me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Nga analizimi në tërësi i natyrës së mallrave të furnizuara, konstatohet se ankimuesi ka provuar se ka furnizuar mallra të cilat për nga natyra nuk janë të gjitha të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre janë artikuj dhe furnizime mekanike (defkon, grupelavamani, kapak EC, pompa saracineska, rubineta etj.), materiale elektrike (automat, drozel, kablla të ndryshëm, llampa, ndricues etj.), brava fishekë dyersh, furca, cemento etj., të cilat po të zbriten nga vlera totale 2.320.227 lekë, diferenca e mbetur është 150.810 lekë pa tvsh, vlerë e cila nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizime të ngjashme në një vlerë prej 833.100 lekë pa tvsh, apo 40% të fondit limit të kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik”, pasi shuma e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është në një vlerë më të vogël se 40% e vlerës totale të fondit limit të parashikuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”

Ankimuesi pretendon se me shkresën e autoritetit kontraktor është njohur në datën 06.06.2019.

II.5. Në datën 07.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 20.06.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1046/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 480 prot., datë 17.06.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Bolt” sh.p.k se *nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizime të ngjashme*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 1, të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

1. Furnizime të ngjashme me vlerë 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit .

Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 10, “*Sasia dhe grafiku i lëvrimit*”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia	Sasia
1	Boja vijezi mirëmbajtje akrilike spray	kg	4,095
2	Fosfori	kg	1,200

Afatet e lëvrimit: duke filluar nga data e lidhjes te kontrates me përfundim në 31.12.2019.

III.1.3. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k., ka paraqitur:

1. Kontratë nr. 4834/3, datë 27.07.2015, lidhur ndërmjet Komandës Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr.4001 dhe operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., me objekt “*Blerje materiale për mirëmbajtje kazermash*”, me vlerë kontrate 28.905.399 lekë pa tvsh, shoqëruar me fatura tatimore shitje dhe vërtetim realizimi dt. 3.3.2016.
2. Kontratë nr. 4049/7, datë 31.08.2016, lidhur ndërmjet Komandës së Forcës Tokësore, Reparti Ushtarak nr.1001 Zall-Herr Tiranë dhe operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., me objekt “*Blerje materiale kazermimi për mbështetjen e stërvitjes Joint Effort Biza 2016*”, me vlerë kontrate 2.320.227 lekë, pa tvsh, shoqëruar me faturë tatimore shitje dhe vërtetim realizimi.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: - Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. - Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

III.1.6. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, përsa i përket Kontratës nr. 4834/3, datë 27.07.2015, lidhur ndërmjet Komandës Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr.4001 dhe operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., me objekt *“Blerje materiale për mirëmbajtje kazermash”*, me vlerë kontrate 28.905.399 lekë pa tvsh, rezulton se kjo kontratë nuk është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, sic kerkohet në dokumentet e tenderit, ndaj dhe nuk mund të vlerësohet si përvojë e mëparshme, në kuptim të nenit 46 të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar.

Nga shqyrtimi i materialeve, objekt i kontratës nr. 4049/7, datë 31.08.2016, lidhur ndërmjet Komandës së Forcës Tokësore, Reparti Ushtarak nr.1001 Zall-Herr Tiranë dhe operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., me objekt *“Blerje materiale kazermimi për mbështetjen e stërvitjes Joint Effort Biza 2016”*, me vlerë kontrate 2.320.227 lekë, pa tvsh, Komisioni konstaton se materialet e ofruara në këtë kontratë, janë në tre grupime; 1. Materiale ndërtimi, 2. Materiale mekanike dhe 3. Materiale elektrike. Në artikujt e materialeve mekanike dhe elektrike, asnjë prej tyre nuk konsiderohet i ngjashëm me objektin e prokurimit, ndërsa në zërin “material ndërtimi”, artikujt si: brava, dryna, fishekë brave, furca, doreza, rrjetë, rul, qese, element alumini, vida, varëse, upa, flutura, bashkues elementësh, mbajtëse celsash gjithashtu nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit i cili në rastin konkret është *“Boje sinjalistike horizontale”*. Nga vlera totale e kontratës po në zbriten artikujt që nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, vlera e mbetur e materialeve

të ngjashme nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizime të ngjashme në një vlerë prej 833.100 lekë pa tvsh ose 40% e fondit limit.

Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, në masën e kërkuar nga AK, e për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 1 të shtojcës 8, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k., për procedurën e prokurimit Nr.REF-20671-05-06-2019, me objekt: *“Boje sinjalistike horizontale”*, me fond limit 2.082.750 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.05.2019 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1046 Protokolli

Datë 07.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha